

VENDIM
Nr.67, datë 7.2.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E CILA PREKET NGA NDËRTIMI I NJË KANALI,
QË SISTEMON UJËRAT, QË DALIN NGA NJË TOMBINO NË KM 29-870, NË
SEGMENTIN RRUGOR RROGOZHINË-ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga ndërtimi i një kanali, që sistemon ujërat, që dalin nga një tombino, në km 29-870, në segmentin rrugor Rrogozhinë-Elbasan.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, për sipërfaqen 1285 m² tokë/arë, e vlerësuar me 700 lekë/m² dhe kulturë bujqësore, e vlerësuar me 6040 (gjashtë mijë e dyzet) lekë, vlerësuar në shumën e përgjithshme 905 540 (nëntëqind e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 123 000 (njëqind e njëzet e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 905 540 (nëntëqind e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit mars 2007.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarit brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PRONARI, PASURIA E TË CILIT DO TË SHPRONËSOHET SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
NJË KANALI, QË SISTEMON UJËRAT, QË DALIN NGA NJË TOMBINO NË KM 29-870 NË
SEGMENTIN RRUGOR RROGOZHINË-ELBASAN

Nr.	Emri	Zona kadastrale	Pasuria	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Kultura jonxhë Vlera në lekë	Vlera totale e shpronësimit
1.	Xhavit Xhemal Ballhysa	1452	104/15 105/3	1285	700	899500	6040	905 540
	Shuma							905 540

Vlera totale e këtij shpronësimi është 905 540 (nëntëqind e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë.